



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 51 regjistër (JR)
Datë 17.10.2019

Nr. 19 i vendimit
Datë 30.7.2020

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ardian Hajdari	Kryesues
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 30.07.2020, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 51 (JR), datë 17.10.2019, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 169, datë 26.06.2019, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, me detyrë gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjyqësor i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore publike, me praninë e Komisionerit Publik dhe në mungesë të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për rrjedhojë në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, znj. Regleta Panajoti i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor¹, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht deklaratën e pasurisë², deklaratën për kontrollin e figurës³, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional⁴.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
 - (i) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin;
 - (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - (v) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Në raportin e saj, DSIK-ja përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore dhe se, për subjektin e rivlerësimit, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, DSIK-ja konstatoi përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti ({}***}), për vazhdimin e detyrës.
5. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

¹ Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaratës së pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

² Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 25.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. extra prot., datë 25.01.2017. Të njëjtën datë mban edhe deklarata e pasurisë në rubrikën përkatëse.

³ Referuar raportit mbi kontrollin e figurës, të përgatitur nga grupi i punës pranë DSIK-së.

⁴ Referuar raportit nr. {}***} prot., datë 01.11.2018, të Inspektoratit pranë KLD-së për “Analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, për periudhën 08.10.2013 deri më 08.10.2016”.

6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 169, datë 26.06.2019.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni, me vendimin nr. 169, datë 26.06.2019, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

8.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë, Komisioni çmon se parregullsitë formale, të konstatuara në deklarime apo dukja e mungesës së të ardhurave në momente të caktuara përgjatë deklarimeve të pasurisë ndër vite, nuk ka pasur për qëllim fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurisë. Nisur nga rrethanat konkrete, bashkëpunimi i subjektit të rivlerësimit dhe gatishmëria e tij për të vënë në dispozicion me vërtetësi informacionin e kërkuar, Komisioni vlerëson se parregullsitë formale të konstatuara dhe mungesa e burimit të ligjshëm për shumën prej 870.873 lekësh nuk janë si shkak i mjaftueshëm që plotëson nivelin e kërkuar për qëllim të zbatimit të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive formale, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

8.2 Në lidhje me kontrollin e figurës, nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente lidhur me problematika të mundshme mbi figurën apo që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës; Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe se është në kushtet e përshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës si gjyqtare.

8.3 Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”, duke arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Florian Ballhysa, më datë 18.09.2019, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 169, datë 26.06.2019, për subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, duke pretenduar se nga shqyrtimi i vendimit të sipërcituar të Komisionit, paraqiten rrethana të tilla ligjore dhe fakti, për të cilat është paraqitur ankim në raste të njëjta, apo për të cilat është depozituar

rekomandim nga ana e një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë të ONM-së. Për rrjedhojë, sipas tij, vendimi i Komisionit nr. 169, datë 26.06.2019, është i cenushtëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim pranë Kolegjit, nëpërmjet ankimit.

10. Komisioneri Publik, referuar ankimit të tij kundërshtoi vendimin e sipërcituar të Komisionit, pasi vlerësoi se lidhur me faktet dhe provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Regleta Panajoti, referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet ankimit dhe, në përfundim të gjykimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

° *Ndryshimin e vendimit nr. 169, datë 26.06.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti.*

11. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurive, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

11.1 *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me nr. {***}, me sip. 104,23 m², ZK nr. 8210, me adresë në Rrugën {***}, Tiranë, Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për vlerën e pasurisë së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike të vitit 2003; nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga puna në emigracion, në shumën e pretenduar prej 3.500.000 lekësh, si dhe të të ardhurave të pretenduara nga aktiviteti i shoqërisë “{***}” ShPK, në shumën 200.000 lekë, gjithsej për një vlerë prej 3.700.000 lekësh.*

11.2 *Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi” me nr. {***}, me sip. 64,8 m², ZK nr. {***}, me adresë në Rrugën {***}, Tiranë, konkluzioni i Komisionit lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të për ta krijuar këtë pasuri, nuk bazohet në një vlerësim të drejtë ligjor të të gjitha provave, fakteve dhe rrethanave të vërtetuara, si dhe me qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, lidhur me elementet e dashjes apo qëllimit në deklarime.*

11.3 *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të kursimeve në gjendje “cash” në banesë, për vitet 2003-2015, dhe në deklaratën e pasurisë “vetting” (12.000 euro në vitin 2007 dhe 2.000 euro për vitin 2016).*

11.4 *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë së luajtshme të llojit “autoveturë {***}” vit prodhimi 2009, pasi rezulton se ka qenë në mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar kryerjen e shpenzimeve dhe krijimin e kësaj pasurie me një diferencë negative prej 125.916 lekësh.*

IV. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes në Kolegji

12. Subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, në datën 24.06.2020 (një ditë përpara datës së caktuar për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike), nëpërmjet komunikimit elektronik me *e-mail* në adresë të sekretarisë së Kolegjit, njoftoi këtë të fundit lidhur me kërkesën e saj drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), për dorëheqjen nga detyra e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

13. Në përgjigje të kërkesës së Kolegjit, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të datës 25.06.2020, KLGj-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 29.06.2020, informoi Kolegjin se znj. Regleta Panajoti, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 24.06.2020, ka depozituar pranë KLGj-së një kërkesë me shkrim, protokolluar me nr. {***}, nëpërmjet së cilës ka parashtruar dorëheqjen nga detyra e gjyqtares. Ndërkohë, në datën 26.06.2020, znj. Panajoti, sikundër referohet në shkresën e sipërcituar, ka depozituar pranë KLGj-së një kërkesë tjetër me shkrim, protokolluar me nr. {***}, nëpërmjet së cilës, në funksion të dorëheqjes së paraqitur më datë 24.06.2020, ka kërkuar që kjo dorëheqje të japë efekt “jo më larg se data 08.07.2020”.
14. KLGj-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 07.07.2020, i ka njoftuar subjektit të rivlerësimit vendimin e saj nr. 239, datë 07.07.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti” dhe njëkohësisht ka bërë me dije lidhur me këtë vendim Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Kolegjin, duke u përcjellë edhe një kopje të tij.
15. Subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, nëpërmjet *e-mail*-it të datës 08.07.2020, të dërguar nga adresa e saj elektronike private në adresën elektronike të sekretarisë së Kolegjit, në vijim të njoftimit të kryer nga Kolegji, ka konfirmuar marrjen dijeni të shkresës së KLGj-së nr. {***} prot., datë 07.07.2020, dhe të vendimit të KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti”. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar nëpërmjet nënshkrimit të saj në dëftesën e komunikimit me nr. 1067/62 regj., datë 08.07.2020, marrjen e këtyre shkresave edhe nëpërmjet shërbimit postar në adresën e saj të banimit, më datë 13.07.2020.
16. Në komunikimin elektronik të datës 08.07.2020, subjekti i rivlerësimit, lidhur me ftesën që i bëri trupi gjykues për t’u paraqitur në seancë gjyqësore publike për t’u dëgjuar në lidhje me vullnetin e saj për vijimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, është shprehur: *Deklaroj se është tërësisht i panevojshëm zhvillimi i një seance dëgjimore (e paracaktuar më datë 10.07.2020), për më tepër mbas kësaj vendimmarrjeje të KLGj-së dhe për sa kohë vullneti im për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit, për shkak të mbarimit të statusit të magjistratit, është i qartë dhe i pavesuar. Ky vullnet konfirmohet si i tillë edhe nga vendimi i KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti”.*
17. Në vijim të sa më sipër, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 09.07.2020, në adresë të sekretarisë së Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, paraqiti kërkesën drejtuar Kolegjit, me objekt: “Kërkohet ndërprerja e procesit të rivlerësimit për ish-subjektin Regleta Panajoti, ish-gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Në vijim, nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 29.07.2020, në adresë të sekretarisë së Kolegjit, subjekti i rivlerësimit lidhur me ftesën e ripërsëritur të Kolegjit sipas vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të datës 10.07.2020, për t’u paraqitur në seancë gjyqësore publike për t’u dëgjuar lidhur me kërkesën e saj për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit dhe pasojat ligjore përkatëse, u shpreh: *Kam depozituar në rrugë elektronike me e-mail, datë 09.07.2020, kërkesën time të datës 08.07.2020, me objekt: “Ndërprerje të procesit të rivlerësimit për ish-subjektin Regleta Panajoti, ish-gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë” dhe kam theksuar se është tërësisht e panevojshme mbajtja e seancave të tjera pranë KPA-së. Mbi njoftimin tuaj të datës 10.07.2020 dhe vendimin e KPA-së të së njëjtës datë (në pikën 3 të tij lidhur me ftesën e subjektit për t’u shprehur mbi ligjin), sqaroj se vullneti im për dorëheqje ka qenë dhe është evidentuar qartazi dhe pasoja e këtij vullneti në këtë fazë është ndërprerja e procesit.*

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

18. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

19. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁵ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

20. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 169, datë 26.06.2019, për subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të Komisionerit Publik dhe në mungesë të subjektit të rivlerësimit, megjithëse ishte njoftuar rregullisht.
21. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit të datës 09.07.2020, drejtuar Kolegjit për ndërprerjen e procesit të rivlerësimit të nisur ndaj saj, trupi gjykues, në funksion të shqyrtimit të çështjes, pasi dëgjoi edhe Komisionerin Publik, duke mbajtur në konsideratë faktin se mbarimi i statusit të magjistratit, si rrjedhojë e paraqitjes së kërkesës për dorëheqje përpara KLGj-së⁶, për subjektet në proces rivlerësimi, sjell si pasojë humbjen e statusit si subjekt rivlerësimi *ex officio* në kuptim të parashikimeve të nenit 179/b, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, zbatimin e nenit G të Aneksit të Kushtetutës, çmoi të nevojshme kryerjen e hetimeve lidhur me konfirmimin e faktit se vendimi i KLGj-së për mbarimin e statusit të magjistratit për subjektin e rivlerësimit në fjalë ka marrë formë të prerë. Për rrjedhojë, trupi gjykues me vendimin e

⁵ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 169, datë 26.06.2019, për rivlerësimin e subjektit, znj. Regleta Panajoti, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik më datë 04.09.2019, me shkresën nr. {***} prot. të së njëjtës datë, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 18.09.2019, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 18.09.2019, që rezulton të jetë dita e 14-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

⁶ Shih nenet 64 dhe 65 të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

ndërmjetëm⁷ të datës 10.07.2020, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vendosi:

(i) t'i kërkojë KLGj-së informacion lidhur me njoftimin dhe konfirmimin e marrjes dijeni nga ana e subjektit të rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, të vendimit të KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti";

(ii) në varësi të përgjigjes së KLGj-së, të konfirmojë me Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, nëse ndaj vendimit të KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti", është ushtruar ankim brenda afatit ligjor;

(iii) të njoftojë dhe të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, për t'u dëgjuar nga Kolegji në lidhje me kërkesën e saj për ndërprerje të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe pasojat ligjore që rrjedhin prej saj.

22. Në zbatim të vendimit të mësipërm të trupit gjykues, KLGj-ja, në datën 17.07.2020, i konfirmoi Kolegjit⁸ se njoftimi i vendimit të sipërcituar është kryer sipas mënyrave të përcaktuara në nenin 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, konkretisht: *i) në adresën postare elektronike zyrtare të znj. Panajoti në datën 07.07.2020; ii) me postë në adresën e vendit të punës së subjektit të rivlerësimit, me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 07.07.2020, depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kjo e fundit ka konfirmuar marrjen e shkresës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, më datë 08.07.2020.* Gjithashtu vendimi i KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti", është publikuar në faqen zyrtare në internet të këtij institucioni, më datë 08.07.2020.

23. Ndërkohë Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm të trupit gjykues të Kolegjit të datës 10.07.2020, konfirmoi⁹ se pranë saj deri në orën 16:00 të datës 28.07.2020, nuk ishte paraqitur ankim kundër vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 239, datë 07.07.2020, "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti".

24. Në analizë të fakteve të parashtruara më sipër, trupi gjykues, pasi konstatoi se:

24.1. Subjekti i rivlerësimit, në saje të kërkesës së vet për dorëheqje nga detyra, të paraqitur para KLGj-së më datë 24.06.2020, ka humbur statusin e magjistratit, deklaruar kjo me vendimin e KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, "Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti".

24.2. Akti administrativ individual i sipërcituar, sipas KLGj-së, i është njoftuar rregullisht subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit 98 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" nga ana e vetë organit administrativ, sikundër dhe nga Kolegji, në përputhje me parashikimet e nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe neneve 4, pika 5 dhe 47 të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor, për sa kohë pasojat ligjore që prodhon ky akt ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në karrierën profesionale të znj. Panajoti.

⁷ Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 10.07.2020.

⁸ Sipas shkresës së KLGj-së nr. {***} prot., datë 17.07.2020, me lëndë "Kthim përgjigjeje".

⁹ Sipas shkresës së Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr. {***} prot., datë 28.07.2020, me lëndë "Kthim përgjigjeje".

24.3. Referuar parashikimeve në fuqi për njoftimin e kryer subjekteve të rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka marrë djeni rregullisht lidhur me vendimin e KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtaren e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Regleta Panajoti”, konfirmuar ky fakt dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, më datë 08.07.2020, në rrugë elektronike dhe më datë 13.07.2020, në rrugë postare.

24.4. Referuar sa më sipër, si dhe pikës 4 të vendimit të KLGj-së nr. 239, datë 07.07.2020, në të cilin parashikohet se ndaj vendimit në fjalë mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, vendimi i sipërcituar i KLGj-së, në datën 28.07.2020, ora 16:00, komunikuar në korrespondencën zyrtare të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka qenë i formës së prerë.

– arrin në përfundimin se, me dhënien e dorëheqjes nga detyra e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përpara KLGj-së dhe pasi vendimi i kësaj të fundit për deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit ka marrë formë të prerë, subjekti i rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti, ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni G i Aneksit të Kushtetutës dhe, për rrjedhojë, bëhet subjekt i zbatimit të kësaj dispozite kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin G të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 169, datë 26.06.2019, për subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti.
2. Ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Regleta Panajoti.
3. Ndalimin e emërimit të znj. Regleta Panajoti gjyqtare ose prokurore e çdo niveli, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshme, për një periudhë 15-vjeçare.
4. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 30.07.2020, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUES

Ardian HAJDARI

nënshkrimi